

PROCESVERBAL

nga seanca e 8-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizive
mbajtur më 24.02.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini, zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Llazar Trajçev, dr. Metodija Jançeski, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr.Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr.Emilija Janevska, Maja Damevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë:/

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski, hapi seancën e 8-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 11:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Z. Petrushevski shpjegoi se nën pikën Të ndryshme do të shtohen edhe tre pika, përkatësisht: Fillimi i procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të RADIO RED FM për shkak të shkeljes së nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV dhe dy pika për ndalimin e procedurës së iniciuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Ra Galaksi dhe RA Xhez FM, për shkak se kanë paguar kompensimin në afatin plotësues.

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri ndryshimin e mëposhtëm:

RENDI I DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 7-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, mbajtur më 18.02.2025.
2. Raport për Llogarinë vjetore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për vitin 2024 me Propozim-vendim për miratimin e llogarisë vjetore.
3. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR TV NJUZ SHPKNJ Kumanovë, për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR TV NJUZ SHPKNJ Kumanovë, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media.

5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.
6. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, për shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV.
7. Projekt-rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensimet tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive.
8. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbim: Mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për punë juridike, financiare dhe ekonomike.
9. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim të shërbimit: punë ndërtimore - zejtari me vlerë të parashikuar nën pragun e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik.
10. Të ndryshme.
 - 10.1 Fillimi i procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të RADIO RED FM për shkak të shkeljes së nenit 80, paragrafi (5) të LSHMAAV.
 - 10.2 Ndalimi i procedurës së nisur për heqjen e lejes për transmetim në radio të RA Galaksi për shkak të pagesës së kompensimit në afatin plotësues.
 - 10.3 Ndalimi i procedurës së nisur për heqjen e lejes për transmetim në radio të RA Xhez FM për shkak të pagesës së kompensimit në afatin plotësues.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi procesverbalin e propozuar nga seanca e 7-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, mbajtur më 18.02.2025.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr. Emilija Janevska, ka bërë vërejtje teknike lidhur me Pikën 4. Ajo ka sqaruar se gjatë përgjigjes së pyetjes së parashtruar nga z.Ajdini, ndihmës udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, pa dashje ka bërë një gabim. Në këtë kontekst, propozoi ndryshim të formulimit “deri më 20 nëntor të po këtij viti” të zëvendësohet me “në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit”.

Këshilli i Agjencisë, me korrigjimin e udhëheqëses Janevska, me 5 vota "pro" dhe një abstenim nga z.Jançeski, miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 7-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, mbajtur më 18.02.2025.

Pika 2

Z. Trajçevski shpjegoi Raportin për Llogarinë Vjetore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për vitin 2024 me Propozim-vendim për miratimin e llogaris vjetore. Ai ka shpjeguar se Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, në përputhje me Ligjin për kontabilitet të organizatave jofitimprurëse, dorëzon Llogarinë Vjetore

për vitin 2024, më së voni deri më 28 shkurti të vitit aktual. Gjithsej të ardhurat e realizuara në vitin 2024 janë 136.610.658,00 denarë. Pjesa më e madhe e këtyre të ardhurave, përkatësisht 75.309.086,00 denarë, që paraqet 55,13% nga gjithsej të ardhura, janë për financimin e veprimtarisë radiodifuzive nga Buxheti i RMV-së. Me ndryshimet ligjore që hynë në fuqi më 28 korrik 2023, duke filluar nga gushti 2023, nga Buxheti i RMV-së duhet të ndaheshin mjete për financimin e veprimtarisë radiodifuzive në vlerë prej 1% nga të ardhurat tatimore të realizuara të përcaktuara në llogarinë e fundit përfundimtare të miratuar të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga të cilat 5% janë destinuar për financimin e Agjencisë. Në fund të vitit 2024, për shkak se Agjencia ka parashtuar padi kundër Ministrisë së Shoqërisë Informative dhe Administratës, përkatësisht tani Ministrisë së Transformimit Dixhital, për shkak të mosrespektim të detyrimit ligjor për pagesë të shumës së përcaktuar saktësisht të mjeteve në përputhje me ndryshimet e LSHMAAV, në fund të dhjetorit 2024, janë paguar 3.685.270,00 denarë plotësuese për vitin 2023 dhe shumë prej 5.950.163,00 denarë si plotësuese për vitin 2024. Gjuthashtu është paguar në tërësi shuma e kërkuar nga Agjencia për tarifë gjyqësore, përkatësisht për ekspertizë ekonomike për të përcaktuar shumën e mjeteve që Ministria i detyrohet Agjencisë. Pastaj, të ardhurat nga Buxheti për aktivitetet zgjedhore të zhvilluara në vitin 2024 (zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale) në shumë prej 4.197.302,00 denarë. Nga lejet për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive janë realizuar të ardhurat në total prej 45.577.501,00 denarë, ndërsa nga mbikëqyrja për ritransmetimin e shërbimeve programore dhe shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë janë realizuar të të ardhura prej 10.422.602,00 denarë. Të ardhurat e mbetura janë realizuar nga faturat tranzit në shumë prej 858.310,00 denarë, të ardhura tjera në shumë prej 244.301,00 denarë dhe diferenca pozitive të kursit në shumë prej 1.556,00 denarë. Shpenzimet e realizuara në tërësi në vitin 2024 janë 128.669.018,00 denarë. Shpenzimet më të mëdha janë për pagesën e pagave bruto të punëtorëve në Shërbimin Profesional, në vlerë prej 68.745.073,00 denarë, që paraqet 53,42% të shpenzimeve në total. Shpenzimet tjera më të mëdha kanë të bëjnë me kompensimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë në shumë prej 11.759.574,00 denarë, për servisimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të Agjencisë në shumë prej 8.568.893,00 denarë, shpenzime për energji elektrike dhe ngrohje të shpenzuar në shumë prej 3.749.190,00 denarë, për blerje të pajisjeve dhe blerje të lejeve dhe të drejta të tjera, janë shpenzuar mjete në shumë prej 6.687.949,00 denarë dhe shpenzime për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm përmes Agjencisë për punësim të përkohshëm, për angazhimin e birosë për përkthim, për mirëmbajtje të higjenes në ambientet zyrtare një shumë prej 7.878.262,00 denarë. Të ardhurat në total të realizuara në vitin 2024 janë më të larta për 7.941.640,00 denarë në krahasim me shpenzimet e realizuara në total. Kërkesat në total të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, sipas llogarisë vjetore për vitin 2024, arrijnë në 3.250.117,00 denarë dhe më së shumti kanë të bëjnë me faturat e dhëna në vitet e kaluara. Detyrimet në total që Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale i ka ndaj kreditorëve sipas llogarisë vjetore për vitin 2024 që janë 1.923.831,00 denarë. Këto borxhet i referohen vonesave detyrimet që janë paguar në janar 2025. Vlera kontabël e mjeteve bazë në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive në fund të vitit 2024 ishin në shumë 288.061.322,00,00 denarë. Në vitin e ardhshëm 2024 do të transferohen mjete në shumë totale prej 135.364.075,00 denarë.

Këshilli i Agjencisë pranoi Raportin për Llogarinë Vjetore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024 nr. 05-740/1 datë 20.02.2025 dhe njëzëri miratoi Vendim për miratimin e Llogarive Vjetore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për vitin 2024.

Në pajtim me nenin 19 të Ligjit për kontabilitet të organizatave jofitimprurëse, Llogaria Vjetore dorëzohet në Drejtorinë e të Ardhurave Publike dhe në Regjistrin e Llogarive Vjetore në Regjistrin Qendror deri në fund të muajit shkurt të vitit të ardhshëm.

Sektori për mbështetjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, vendimi e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pikat 3 dhe 4

Z. Petrushevski propozoi për Pikën 3 dhe Pikën 4 të bëhet një hyrje e përbashkët, pasi në të dyja rastet është i njëjti medium. Më pas, çdo propozim për shqiptimin e masës të vihet në votim individual.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr.Emilija Janevska, shpjegoi propozimet për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë për shkelje të nenit 51, paragrafit (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (LSHMAAV) dhe nenit 14 të Ligjit për Media. Ajo shpjegoi se shkeljet në këtë media janë konstatuar përmes mbikëqyrjes së kontrollit administrativ zbatuar më 28 janar 2025. Transmetuesi paraprakisht është sanksionuar në seancën e mbajtur më 26 dhjetor 2024, kur janë shqiptuar masa për mos respektim të neneve nga Ligji i lartpërmendur, me afat harmonizimi prej 20 ditësh nga dita e pranimi të Akvendimit. Me mbikëqyrjen e kontrollit administrativ në janar është konstatuar se transmetuesi nuk ka vepruar sipas masave të shqiptuara, pra sërish janë konstatuar të njëjtat shkelje. Neni 51 paragrafi (1) të LSHMAAV i referohet detyrimit të transmetuesit që informacioni t'i vihet në dispozicion të përdoruesve në mënyrë të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme, ndërsa neni 14 i Ligjit për Media i referohet detyrimit për publikim impresium, përkatësisht informacion për pjesëmarrësit në prodhimin e programeve konkrete. Duke qenë se të njëjtat shkelje janë evidentuar sërish, propozohet që sërish të shqiptohen masa vërejtje publike, në përputhje me Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë, me afat të përcaktuar për harmonizim prej 20 ditësh nga dita e pranimi të Akvendimit. Pas skadimit të afatit do të realizohet mbikëqyrje kontrolli shtesë për të përcaktuar nëse transmetuesi ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Votimi për pikën 3

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të kontrollit administrativ nr.10-557/1 datë 04.02.2025 dhe njëzëri konkludoi që SHTR TV NJUZ Kumanovë, t'i shqiptohet masa vërejtje publike për shkelje të nenit 51, paragrafi (1) të LSHMAAV, për shkak se më 28 janar 2025, nuk ka ofruar informacionin që duhet t'u vihen në dispozicion përdoruesve.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave nr.01-4139/1, datë 07.11.2022, detyrohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit të harmonizon veprimtarin e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Akvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj transmetuesit të lartpërmendur.

Sektori për çështje programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes

(transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për mbështetjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë ka shqyrtuar Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të kontrollit administrativ, nr.10-558/1 të datës 04.02.2025 dhe njëzëri ka konstatuar se SHTR TV NJUZ Kumanovë, t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media , për shkak se më 28 janar 2025, nuk ka publikuar të dhënat për impresium të Festivalit të Këngës dhe Valleve Shqipe, inçizimin e ngjarjes së zhvilluar me rastin e vendosjes së tre shkronjave të UÇK-së në fshatin Tanushë, dhe inçizimin e manifestimit të mbjtur me rastin e Ditës së Alfabetit Shqip.

Në përputhje me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave nr. 01-4139/1, datë 07.11.2022, është urdhëruar që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Media.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj transmetuesit të lartpërmendur.

Spektori për çështjeve programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryer mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për mbështetjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmenduar ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pikat 5 dhe 6

Z. Petrushevski shpjegoi që për Pikën 5 dhe Pikën 6 të bëhet një hyrje e përbashkët, pasi në të dyja rastet është i njëjti medium. Më pas, çdo propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të vihet në votim individual.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr. Emilija Janevska, shpjegoi propozimet për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJG Gostivar për shkelje të nenit 50 paragrafit (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve, si dhe neni 92 paragrafi (1) të LSHMAAV. Ajo ka shpjeguar se në seancën e mbajtur më 26 dhjetor 2024, këtij transmetuesi i janë shqiptuar dy masa për shkelje të konstatuara përcaktuar me mbikëqyrje programore. Masa e parë ka të bëjë me mos respektimin e nenit 50, paragrafit (3) të LSHMAAV dhe neneve 16, 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve, ndërsa masa e dytë ka të bëjë me shkeljen e nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV, që ka të bëjë me detyrimin për transmetimin e veprave audiovizive maqedonase. Transmetuesit i është dhënë afat për harmonizim prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit për të dyja arsyet. Mbikëqyrja e kontrollit programor e kryer më 27 janar 2025 ka rezultuar se transmetuesi pjesërisht ka vepruar sipas dy masave të shqiptuara. Në lidhje me shkeljen e nenit 50

paragrafi (3) të LSHMAAV dhe neneve 16, 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve, u konstatua se transmetuesi kishte eliminuar shkeljen e nenit 16, i cili i referohet periudhës kohore për kategoritë e programit. Megjithatë, ka vazhduar me shkelje të nenit 20 dhe 21 të Rregullores, të cilat kanë të bëjnë me pamjen dhe mënyrën e aplikimit të sinjalistikës paralajmëruese. Analiza ka treguar se në disa përmbajtje të transmetuara në ditën e mbikëqyrjes, transmetuesi ka përdorur sinjalizim të gabuar paralajmërues, i cili nuk është në përputhje me Rregulloren. Në lidhje me nenin 92, paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV, është konstatuar se transmetuesi e ka eliminuar shkeljen lidhur me përqindjen e veprave audiovizive maqedonase në periudhën prej orës 07:00 deri në ora 19:00. Megjithatë, ai nuk e ka eliminuar shkeljen në lidhje me përqindjen ditore të veprave audiovizive maqedonase. Në vend të 30% të përcaktuar me ligj në bazë ditore, në ditën e monitorimit janë transmetuar 22,88%, që paraqet mungesë prej 1 orë, 28 minuta dhe 11 sekonda të përmbajtjes audiovizive maqedonase. Për këto arsye, në përputhje me Udhëzimin për caktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë, propozohet shqiptimi sërish i masës vërejtje publike për të dyja arsyet, me afat harmonizimi prej 20 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit. Pas skadimit të këtij afati do të kryhet mbikëqyrje kontrolli plotësuese për të përcaktuar respektimin e detyrimeve ligjore.

Votimi për pikën 5

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me Shkrim për mbikëqyrje të kryer të kontrollit programor, nr.10-563/1 datë 05.02.2025 dhe njëzëri konkludoi që SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJPL Gostivar, t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve, sepse më 27 janar 2025, para transmetimit të disa programeve të kategorisë së parë, të dytë dhe të katërt, është përdorur sinjal paralajmërues i gabuar për mbrojtjen e të miturve, që nuk është paraparë me Rregullore.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, detyrohet që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Rregulloren për mbrojtjen e të miturve.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Akvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj transmetuesit të lartpërmendur.

Spektori për çështjeve programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Akvendimin për vërejtje publike, të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipa masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për mbështetjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 6

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me Shkrim për mbikëqyrje të kryer të kontrollit programor, nr.10-569/1 datë 06.02.2025. dhe njëzëri konkludoi që SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJPL Gostivar, t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të

LSHMAAV, sepse më 27 janar 2025 nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizive maqedonase.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, urdhërohet që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masë vërejtje publike ndaj transmetuesit të lartpërmendur.

Sektori për çështjeve programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Sektori për mbështetjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 7

Z. Trajçevski shpjegoi Projekt-rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensimet tjera të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale. Ai ka shpjeguar se me ndryshimet e propozuara të Rregullores, përfshijnë Kryetarin e Këshillit, zëvendësin e tij dhe anëtarët e Këshillit, me koeficientë të njëjtë me anëtarët aktualë të Këshillit. Dallimi është se anëtarët e rinj që do të zgjidhen do të kenë angazhim profesional në Agjenci, me orar të plotë pune dhe në marrëdhënie të rregullt pune. Të gjitha ndryshimet e tjera të Rregullores janë plotësisht në përputhje me nenin 12, paragrafin (4) të LSHMAAV, si dhe me Ligjin për pagat dhe kompensimet tjera të personave të zgjedhur dhe të emëruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Z. Petrushevski shprehu rezerva në lidhje me ndryshimet e propozuara, duke theksuar se edhe gjatë miratimit të Ligjit publikisht ka treguar se një zgjidhje e tillë nuk do të funksionojë dhe se mund të paraqiten probleme në punën e shërbimit ekspert, sepse përveç drejtorit të Agjencisë, dhe shtatë anëtarët e Këshillit mund të sillen sikur të jenë persona udhëheqës të punëtorëve. Natyrisht, kjo varet nga kapaciteti i anëtarëve të ardhshëm, gjithashtu ekziston rrezik i lartë të problemeve në lidhje me hierarkinë. Ai theksoi se Agjencia aktualisht paguan kompensim për anëtarët aktualë të Këshillit dhe mbulon 10% tatim personal për secilin prej tyre. Me ndryshimet e reja, Agjencia do të financojë 50% më shumë mjete në krahasim me modelin aktual, që do të thotë se ka implikime të konsiderueshme financiare dhe është e pakuptueshme pse ligjvënësi ka marrë një vendim të tillë. Duke iu referuar nenit që parashikon se anëtarët e Këshillit mund të kenë deri në katër paga mesatare, ai theksoi se kjo i referohet shumës neto që rezulton nga paga bruto, e cila sjell deri në shpenzime të konsiderueshme. Po ashtu, ai shprehu dyshimin se anëtarët aktualë të Këshillit janë duke miratuar Rregullore që do të zbatohet për pasardhësit e tyre, por drejtori ka shpjeguar se Rregullorja duhet të miratohet me kohë. Ndonëse mund të interpretohet si vendim subjektiv, z.Petrushevski mendon se mjetet financiare të parapara me ndryshimet janë të larta dhe se ai personalisht do t'i zvogëlonte. Sa i përket kompensimit për shfrytëzimin e veturës private për qëllime zyrtare, ai shprehu pajtim, duke thënë se është më i pranueshëm në krahasim me masën e kompensimit të ngjashme tek deputetët dhe nuk ka vërejtje dhe për pagesën e largimit me rastin e daljes në pension. Në lidhje me kompensimin për pushim vjetor, ai ka kërkuar sqarim

nga drejtori nëse ky kompensim është ekuivalent me K-15, për të cilën ka marrë përgjigje pohuese. Sa i përket të drejtës për kompensim për jetesë të ndarë deri në 30% të pagës mesatare mujore neto, kjo nuk i duket logjike sepse anëtarët e propozuar të Këshillit figurojnë sikur janë nga Shkupi, e njëjta gjë vlen edhe për kompensimin për shpenzimet e transferit. Kompensimi për shpenzimet e varrimit parashikohet në masën e dy pagave mesatare mujore neto të anëtarit të Këshillit, ndërsa për punonjësit e Agjencisë arrin në dy paga mesatare, që mund të paraqesë diskriminim. Ankesa më e madhe ka të bëjë me rritjen e barrës financiare të Agjencisë si rezultat i të gjitha këtyre ndryshimeve. Në fund ai kërkoi që të dëgjon edhe mendimet e anëtarëve të tjerë të Këshillit lidhur me ndryshimet e propozuara të Rregullores, pas së cilës do të merrte vendim për votën e tij.

Z. Fidanoski shprehu mirëkuptim të plotë për qëllimin e mirë të diskutimit. Ai shpjegoi se qëllimi i votimit të sotëm është që të bëhen përgatitjet e nevojshme për ardhjen e përbërjes së re të Këshillit. Ai po ashtu theksoi se është i sigurt se propozimi i përgatitur nga Shërbimi Profesional është plotësisht në përputhje me ligjin dhe si anëtarë të Këshillit është obligim që ta respektojnë Ligjin. Për të shmangur keqinterpretimet e mundshme, ai vendosi të përmbahet nga komentet e mëtejshme dhe theksoi se teksti i propozuar për të ishte i pranueshëm në formën në të cilën ishte përgatitur.

Z. Trajçev theksoi se anëtarët e Këshillit nuk duhet të thellohen në çështjen e kompensimit mujor, sepse atë e përcakton ligjvënësi dhe nuk është në kompetencë të tyre. Sa i përket vetë propozimit, ai shprehu vërejtje parimore nëse përbërja aktuale e Këshillit, që po largohet, duhet ta rregullojë këtë çështje për anëtarët e ardhshëm, apo do të ishte më korrekte t'i lihej përbërjes së re që në mënyrë të pavarur ta miratojë Rregulloren. Sipas tij, do të ishte më e udhës që anëtarët e ardhshëm të Këshillit ta rregullojnë vetë këtë çështje.

Z. Trajçevski shpjegoi se qëndrimi i Agjencisë dhe punonjësve është shprehur në Rregulloren e propozuar, e cila në thelb mbetet identike në lidhje me mënyrën e deritanishme të pagesës së kompensimit për anëtarët e Këshillit, me dallimin se tani ata do të marrin pagë në vend të kompensimit. Në lidhje me dilemën e shprehur nga z. Trajçev, ai theksoi se Rregullorja është dashur të miratohet qysh në janar të vitit 2019, kur edhe është ndryshuar Ligji. Mirëpo, meqenëse në atë kohë nuk kishte konkurs aktual për përzgjedhjen e anëtarëve të rinj të Këshillit, as në fazën e realizimit dhe as të shpallur, ai nuk u miratua. Ai theksoi se Këshilli, pavarësisht nëse është në përbërjen e vjetër apo të re, ka detyrim ligjor që ta miratojë ndryshimin e kësaj Rregulloreje. Nëse dhe kur do të zbatohet – për një, dy, tre apo më shumë muaj – mbetet e pasigurt. Rregullorja do të zbatohet vetëm kur të zgjidhen anëtarët e rinj të Këshillit.

Z. Petrushevski tha se i dëgjon mendimet e Këshillit, veçanërisht për shkak të dilemës së tij. Nga diskutimi ai konkludoi se shumica, përfshirë drejtorin, shërbimin dhe një pjesë të Këshillit, mendojnë se nuk duhet të ketë ndërhyrje në përcaktimin e koeficientëve. Prandaj, ka vendosur të përmbahet nga propozimi që fillimisht kishte qëllim të bënte dhe do të mbështesë Rregulloren në formën e propozuar. Megjithatë, ai sinqerisht mbetet në qëndrimin se koeficientët duhet të ishin ulur së paku 10%.

Z. Fidanoski pyeti nëse, duke pasur parasysh se Rregullorja do të zbatohet në përbërjen e re të Këshillit, kjo duhet të specifikohet në nenin e fundit 10. Ai u përgjigj se nuk ka nevojë për specifikim plotësues.

Këshilli i Agjencisë, me 5 vota dhe një abstenim nga z. Trajçev, miratoi Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensimet tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, me tekstin e propozuar.

Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensimet tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive do të publikohet në tabelën e shpalljeve të Agjencisë .

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Teksti të pastruar të Rregullores për pagën bruto dhe kompensimet tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive.

Pika 8

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, ka shpjeguar Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për shërbimin: Mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për punë juridike, financiare dhe ekonomike. Ajo ka shpjeguar se kjo procedurë është e paraparë në Planin Vjetor për furnizim publik, ndërsa mjetet për të janë të parapara në Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2025. Bëhet fjalë për furnizim specifik, i cili do të realizohet me procedurë për negociim pa publikim të shpalljes, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1, pika v), nënparagrafi 3 të Ligjit për furnizim publik, e cila lejohet kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të drejtave ekskluzive. Në vitin 2015, Agjencia ka blerë softuer nga një operator i caktuar ekonomik, ku kodi burim ka mbetur në pronësi të atij operatori. Softueri është ende në përdorim aktiv në Agjenci, prandaj është e nevojshme të sigurohet mirëmbajtja e tij. Në pajtim me Ligjin për furnizim publik, Agjencia ka siguruar miratimin nga Byroja për furnizim publik se janë plotësuar kushtet për zbatimin e kësaj procedure. Të gjitha detajet e tjera rreth kësaj procedure jepen në materialet pas pikës.

Z. Petrushevski tha se vlera e vlerësuar është relativisht e ulët për këtë lloj shërbimi.

Z. Trajçev kujtoi se vitet e kaluara është diskutuar për nevojën e zhvillimit të softuerit personal apo të përdoret softuer i dikujt tjetër. Ai pyeti, duke qenë se ka kaluar kohë që atëherë, nëse ka nevojë për analizë të re ose nëse vlen analiza e mëparshme, e cila tregonte se kjo mënyrë, duke përdorur softuerin e dikujt tjetër, është një opsion ekonomikisht më fitimprurës.

Udhëheqësi i Sektorit për financa dhe logjistikë, Goran Radunoviq, ka shpjeguar se softueri është në përdorim të plotë dhe se çdo vit përshtatet me ndryshimeve ligjore. Sa i përket analizave, ai shpjegoi se nëse do të blihej softuer me kodin personal, do të kushtonte më shumë dhe do të duhej të punësohej një punonjës shtesë për menaxhimin e softuerit, pasi Agjencia ka një numër të madh transaksionesh çdo vit. Gjithashtu, softueri duhet të përshtatet rregullisht me ndryshimet e reja ligjore që mund të ndodhin.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi njëzëri zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për punë juridike, financiare dhe ekonomike.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Mirëmbajtja parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për punë juridike, financiare dhe ekonomike, është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2025 të

Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive nr.05-5321/1 të datës 27.12.2024, ndërsa mjetet sigurohen me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025.

Pika 9

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim të shërbimit: punë ndërtimore dhe zejtare me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik. Ai shpjegoi se ky furnizim ka të bëjë me përshtatjen e zyrave për anëtarët e rinj të Këshillit.

Z. Trajçev pyeti në parim se për çfarë saktësisht do të votojë Këshilli, përkatësisht për cilin vendim. Nëse është për vendimin që është në materiale, ai theksoi se aty figuron kompani e përzgjedhur, por nuk e kupton pse vazhdimisht të vihen kompani, pasi që Këshilli voton vetëm për miratimin e zbatimit të procedurës në kuadër të Ligjit. Më tej, ai shtoi se shërbimet duhet të zbatohen në procedurën, të ofrojnë minimumi tre oferta, që është e drejtë dhe përgjegjësi e tyre.

Z. Petrusovski ka shpjeguar se Këshilli i Agjencisë i jep miratim drejtorit për kryerjen e furnizimit. Sipas ligjit, për çdo shpenzim parash, Këshilli duhet t'i japë miratimin drejtorit.

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahje të punës së Drejtorit dhe Këshillit - shefe e kabinetit, mr.Dragica Ljubevska, ka shpjeguar se Këshilli nuk e voton vendimin. Qartë thuhet në propozimin e dorëzuar nga drejtori në Këshill se kërkohet që drejtorit t'i jepet miratim për miratimin e Vendimit për furnizim të shërbimit: punë ndërtimore dhe zejtare dhe asnjë firmë nuk figuron..

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim që Drejtori i Agjencisë të miratojë vendim për furnizim të shërbimit: punët ndërtimore dhe zejtare në objekt, me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik, në shumë prej 58.679,00 denarë pa TVSH dhe pa TVSH (69.241,00 denarë me TVSH).

Për realizimin e shërbimit të mësipërm mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për vitin 2025.

Pika 10

Të ndryshme

10.1 Udhëheqësi i Sektorit për financa dhe logjistikë, Goran Radunoviq, ka shpjeguar propozimin për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë. Ai shpjegoi se kompensimi duhej paguar deri më 20 shkurt 2025. Meqenëse nuk ka kryer pagesën në afatin e paraparë me ligj, propozohet fillimi i procedurës.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka iniciuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, PA1 nr.08-133, datë 07.09.2023, për shkak të mospërbushjes së detyrimit nga neni 80, paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar me nr. 2025-100-0069 datë 10.01.2025.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, PA1 nr.08-133 datë 07.09.2023, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

10.2-10.3 Z. Trajçevski shpjegoi propozimet për ndalimin e procedurës së iniciuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR XHEZ FM SHPKNJP Shkup dhe SHTR GALAKSI – 2002 SHPKNJP Kavadar. Ai informoi se gjatë seancës ka kryer kontroll në llogarinë e Agjencisë dhe ka konstatuar se nuk ka pasur pagesa nga transmetuesit tjerë, përveç dy të përmendurve. Ndaj tyre është iniciuar procedurë, por në ndërkohë kanë bërë pagesën dhe për këtë arsye propozohet që të merret aktvendim për ndërprerjen e procedurës. Për të gjithë transmetuesit tjerë për të cilët është nisur procedura, afati përfundimtar është 28 shkurt, pas së cilës Këshilli do të duhet të marrë Vendim për heqjen e lejes ose aktvendim për ndërprerjen e procedurës.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim për ndërprerjen e procedurës së iniciuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive XHEZ FM SHPKNJP Shkup, PA1 nr.08-83 datë 07.09.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer nr.05-665/2 të datës 21.02.2025, SHTR XHEZ FM SHPKNJP Shkup, kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio e ka paguar në tërësi, sipas faturës së dorëzuar nr.2025-100-0039 datë 10.01.2025.

Spektori për mbështetjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim për ndalimin e procedurës së iniciuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive GALAKSI - 2002 SHPKNJP Kavadar, PA1 n.r 08-100 datë 07.09.2023 .

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer nr.05-666/2, datë 21.02.2025, SHTR GALAKSI – 2002 SHPKNJP, kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio e ka paguar në tërësi, sipas faturës së dorëzuar nr. 2025-100-0048 datë 10.01.2025.

Spektori për mbështetjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**